Viti 1 - Versioni A

UDHËZIMET E PËRSËRITJES VERBALE

ZBULUESIT

Kohëzgjatja e testit interaktiv: 30 minuta

Udhëzime për ambientin:

- ·Nxënësit duhet të ulen nëpër tavolina për testin.
- ·Çdo nxënës duhet të ketë një Bibël, letrën me përgjigjet, një fletë me udhëzimet dhe një laps.

Atmosfera e klasës:

- Energjike dhe argëtuese
- Pozitive dhe inkurajuese

Vizitorët:

- ·Fëmijët që janë për herë të parë nuk duhet ta bëjnë testin. Në kurikulë mund të gjeni ide për të kaluar kohën me ta.

Udhëzimet për testin:

- ·Testin nuk duhet ta zhvillojë mësuesi kryesor. Një tjetër drejtues duhet ta luajë këtë rol. Personi duhet t'i njohë mirë materialet, të jetë në gjendje të bëjë pyejte të përshtatshme për moshën dhe të mund të riformuloj pyetjet sipas nevojës, që t'i ndihmojë nxënësit t'i kuptojnë.
- ·Sigurohu që nxënësit të shkruajnë qartësisht emrin dhe mbiemrin në letër, duke qenë se mund t'ua jepni më vonë prindërve. Mund t'ua dërgoni rezultatet e përgjithshme mbi tema specifike më vonë.
- ·Pyetjet janë projektuar si pyetje me alternativa, me figura të qarta. Udhëzoji nxënësit se si të qarkojnë përgjigjet e sakta. Nëse është e nevojshme, demonstroje.
- ·Ndihmësi duhet t'i bëjë pyetjet dhe drejtuesi i KZ-së duhet të sigurohet se nxënësit po qarkojnë te pyetja e duhur.
- ·Pikëzimi: Të gjitha përgjigjet e paskta duhen qarkuar në mënyrë që drejtuesi dhe prindërit të shohin se si ka dalë nxënësi. Nëse po përdorni sistem numerik, jepi një pikë çdo përgjigjeje të saktë. Në fillim të faqes 1 të fletës së përgjigjeve, shëno numrin total të përgjigjeve të sakta, nga 25 të mundshme. Nëse dëshironi pikëzim me përqindje, shumëzo numrin e pikëve që ka marrë nxënësi me 100 pastaj pjestoje me numrin total të mundshëm të pikëve.

Pikëzimi:

- Të gjitha përgjigjet e gabuara duhen qarkuar, në mënyrë që drejtuesit dhe prindërit të shohin rezultatet. Nëse përdorni pikëzim numëror, vendosni një pikë për çdo përgjigje të saktë. Në fillim të faqes, vendos pikët që ka marrë nxënësi nga një total i mundshëm prej 25 pikësh. Nëse preferoni pikëzim me përqindje, shumëzoje numrin total të nxënësit me 100, pastaj pjesëtoje me numrin total të mundshëm.

PËRSËRITJA VERBALE

ZBULUESIT

Klasa: _____ Ora: _____ Numri i nxënësve: _____

Kërkoju nxënësve të shkruajnë qartësisht emrin dhe mbiemrin.

BAZAT E BIBLËS

Ndihmësi duhet të shënojë numrin e nxënësve që e plotësojë detyrën pa ndihmë.

1. Nëse e ke marrë Biblën me vete, ngrije lart. (_____)
2. A mund ta hapësh Biblën dhe të gjesh një libër në Dhiatën e Vjetër? (_____)
3. A mund ta hapësh Biblën dhe të gjesh një libër në Dhiatën e Re? (_____)

Thuaj: Shkëlqyeshëm! Që ta dini, Dhiata e Vjetër gjendet në fillim të Biblës ndërsa Dhiata e Re në gjysmën e dytë.

1 - RISHIKIMI I TREMUJORIT

Në seksionin e parë të fletës së përgjigjeve, kërkoju nxënësve të qarkojnë fjalën "E VJETËR" (nën figurën e kronologjisë së Dhiatës së Vjetër), nëse mësimi gjendet në Dhiatën e Vjetër, dhe të qarkojnë fjalën "E RE" (nën figurën e kronologjisë së Dhiatës së Re) nëse mësimi gjendet në Dhiatën e Re.

1. Perëndia krijoi botën. (Dh.V.)
2. Simeoni dhe Ana pritën me durim që të shihnin Shpëtimtarin. (Dh.R.)
3. Noeu iu bind Perëndisë dhe ndërtoi një arkë. (Dh.V.)
4. Jezusi i mësoi njerëzit për Samaritanin e mire. (Dh.R.)

2 - RISHIKIMI I TREMUJORIT

Në seksionin e dytë të fletës së përgjigjeve, kërkoju nxënësve të qarkojnë njërën prej të mëposhtmeve:

- ***Po - nëse përgjigjja është e vërtetë***
- ***Jo - nëse përgjigjja është e gabuar***
- ***Pikëpyetje - nëse nuk e dinë përgjigjen***

1. Shenja e premtimit të Perëndisë për Noeun ishte një ylber. (V)
2. Abrami dhe Sarai pritën me durim Perëndinë që t'u jepte një djalë. (G)
3. Barinjtë u treguan të tjerëve se Jezusi kishte lindur. (V)
4. Të gjithë drejtuesit judenj besuan në Jezusin si Shpëtimtari i tyre. (G)

3 - PYETJE TË PËRGJITHSHME

Kërkoju nxënësve të kthehen te faqja 2.
Në seksionin e 3-të të fletës së përgjigjeve, kërkoju të qarkojnë të mëposhtmet:

- ***Po - nëse përgjigjja është e vërtetë***
- ***Jo - nëse përgjigjja është e gabuar***
- ***Pikëpyetje - nëse nuk e dine përgjigjen***

1. Kur besojmë në Jezusin si Zoti dhe Shpëtimtari ynë bëhemi pjesë e familjes së Perëndisë. (V)
2. Bibla ka disa gabime të vogla. (G)
3. Perëndia do që njerëzit në kishë të kujdesen për njëri-tjetrin. (V)
4. Ka njerëz në botë që nuk e njohin Jezusin. (V)
5. Perëndia premton se do të jemi gjithmonë të lumtur. (G)
6. Qielli është një vend i trilluar. (G)
7. Perëndia di gjithçka rreth meje. (V)

4 - LIBRI PA FJALË

Kërkoju nxënësve të shkojnë te faqja 3. Në seksionin 4 të fletës së përgjigjeve, kërkoju të qarkojnë njërën nga ngjyrat e Librit pa Fjalë për pyetjet e mëposhtme.

1. Cila ngjyrë na kujton se të gjithë kemi mëkatuar? (E zeza)
2. Cila ngjyrë na kujton se Perëndia na do dhe se qielli është i vërtetë? (E arta)
3. Cila ngjyrë na kujton të rritemi si të krishterë? (E gjelbra)
4. Cila ngjyrë na kujton se Jezusi vdiq për mëkatet tona? (E kuqja)
5. Cila ngjyrë na kujton fjalën "i pastër" ose "i falur"? (E bardha)

Bëju këto pyetje dhe, po të jetë e nevojshme, recitoju tre fjalët e para të vargut për t'i ndihmuar.

6. Hebrenjve 9:22b (Pa derdhur gjak…) cilën ngjyrë na kujton? (Të kuqen)
7. Gjoni 14:2 (Në shtëpinë e…) cilën ngjyrë na kujton? (Të artën)
8. 2 e Pjetrit 3:18a (Por rrituni në…) cilën ngjyrë na kujton? (Të gjelbrën)
9. Romakëve 3:23 (Sepse të gjithë…) cilën ngjyrë na kujton? (Të zezën)
10. Veprat 16:31 (Beso në…) cilën ngjyrë na kujton? (E bardhë)

Fleta e përgjigjeve

Viti 2 - Versioni A

PËRSËRITJA VERBALE

ZBULUESIT

Emri: _____ Mbiemri: _____ Totali: _____/ 25

1 RISHIKIMI I TREMUJORIT





(_____/ 4)

1	**E VJETËR**	**E RE**
2	**E VJETËR**	**E RE**
3	**E VJETËR**	**E RE**
4	**E VJETËR**	**E RE**

2 RISHIKIMI I TREMUJORIT

(_____/ 4)

1	👍	👎	?
2	👍	👎	?
3	👍	👎	?
4	👍	👎	?

3 PYETJE TË PËRGJITHSHME

(_____/ 7)

1   

2   

3   

4   

5   

6   

7   


4 LIBRI PA FJALË


(_____/ 10)


1 


2 

3 

4 

5 

6 

7 

8 

9 

10 